



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, dëshmitari i 45-të i thirrur prej Prokurorisë filloi dëshminë të enjten e shkuar pasdite. Dëshmitari, ish-anëtar i UÇK-së, Hajrush Kurtaj, po dëshmon pa masa mbrojtëse. Seanca vijuese e planifikuar për këtë çështje gjyqësore do të mbahet më 20 shkurt, në orën 09:00.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 7 shkurt Trupi Gjykues vendosi se disa pjesë të transkripteve të seancave që janë mbajtur në seancë private në nëntor 2023 dhe janar 2024, mund të bëhen publike. Kjo bazohet në një urdhër të mëparshëm të gjykatësve për Prokurorinë, Mbrojtjen dhe Mbrojtësin e Viktimave që të kryejnë rregullisht rishikim të transkripteve për të parë nëse mund të hiqen redaktimet ekzistuese dhe transkriptet të riklasifikohen si publike, me qëllim respektimin e parimit të publicitetit, duke respektuar njëherazi masat mbrojtëse për dëshmitarët dhe viktimat.

Më 2 shkurt, në të njëjtën çështje gjyqësore, Trupi Gjykues miratoi pjesërisht kërkesën e Prokurorisë për të mos nxjerrë disa dokumente, sepse përmbajnë informacione konfidenciale dhe të ndjeshme që duhet të mbrohen në bazë të nenit 58 të Ligjit të DHSK-së dhe rregullës 107(1), e që lidhen me shtetet e treta apo institucionet ndërkombëtare. Rregulla parasheh se në qoftë se Prokurori i Specializuar ka nën ruajtje ose kontroll informacion që i është dhënë në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për mbledhjen e provave të reja, një informacion i tillë dhe burimi përkatës mbrohen. Materiali ose informacioni fillestar nuk nxirren pa pëlqimin e dhënësit dhe në asnjë rast nuk paraqitet si provë materiale pa iu bërë i ditur paraprakisht të akuzuarit.

Në çështjen gjyqësore *Sabit Januzi dhe Ismet Bajtijari*, Zyra e Prokurorit të Specializuar dorëzoi dosjen paraprake më 2 shkurt, siç ishte urdhëruar prej Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Dosja u dorëzua si konfidenciale për të garantuar masat mbrojtëse të autorizuara më parë dhe Prokuroria tha se do të dorëzojë versionin e redaktuar publik në kohën e duhur. Dorëzimi i dosjes paraprake është hap i rëndësishëm në një proces gjyqësor pasi mundëson fillimin e gjykimit. Dosja përmban, për secilën akuzë, një përmbledhje të provave që Prokurori i Specializuar synon të paraqesë lidhur me kryerjen e krimeve dhe përgjegjësisë penale të pretenduar të të akuzuarve.

Më 5 shkurt 2024, Paneli i Gjykatës së Apelit hodhi poshtë apelin e Sabit Januzit kundër vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake që rrëzonte kërkesën e tij për lirim të përkohshëm. Gjykatësit konstatuan se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk gaboi kur doli me përfundimin se, bazuar në informacionin para tij, asnjë masë shtesë që mund të merret parasysh në mënyrë të arsyeshme, nuk mund të zvogëlojë mjaftueshëm rreziqet e identifikuara të pengimit të procesit dhe kryerjes së krimeve të tjera.





KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**
Nr 05/2024
Hagë, 08/02/2024

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

